# DËSHMI ARKIVI

**A-443749**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Paga mesatare kalon 92 mijë lekë në muaj, por mbi 50% e shqiptarëve nuk e 'kapin' dot! 1 në 4 punonjës, me minimale - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/paga-mesatare-kalon-92-mije-leke-ne-muaj-por-mbi-50-e-shqiptareve-nuk-e-kapin-dot-1-ne-4-punonjes-me-minimale?r=kh1` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 16:10:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:34:39 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e6413dcaa4678c84ecd4a7ad7ccec751e7c1ca340a619806f4653a9d224fb6d6` |
| TEKSTI | `174fcdf5e2c393ccb3882cb240cdcf9019a6e2261dcdd2b28b593bb6b8393764` |
| PAMJA | `feaf54c0ed48a0be7f0eeac057f658c39c4a2e9daf588b166b25a46027e97f32` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4509ad07ff4b2e939f893b3473b95bb2826040050ee2e2f6bda61eac61ea48a2` |
| E MËPARSHMJA | `5c871669d7b6fe75a93405b596eafdb77458e223a917c8066fd440162997adda` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4509ad07ff4b2e939f893b3473b95bb2826040050ee2e2f6bda61eac61ea48a2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





Ekonomi

# Paga mesatare kalon 92 mijë lekë në muaj, por mbi 50% e shqiptarëve nuk e 'kapin' dot! 1 në 4 punonjës, me minimale

*Paga mesatare në Shqipëri ka kaluar 92 mijë lekë, por shumica e shqiptarëve janë ende poshtë kësaj shifre. Gati 1 në 4 të punësuar paguhet me pagën minimale, thotë INSTAT ndërsa vetëm 17% marrin mbi 120 mijë lekë.*

Eliza Gjediku
14 Shtator, 16:25 | **Përditësimi: 14 Shtator, 17:03**

Share Tweet




Paga mesatare mujore në Shqipëri, ka arritur 92.150 lekë në fund të muajit qershor, nga 83.906 lekë që ishte në tremujorin e dytë të vitit të kaluar.

Për periudhën prill-qershor INSTAT thotë se rritja më e madhe është regjistruar në sektorin e ndërtimit, me 22.1%, ku duket se ka dhënë ndikim aksioni i tatimeve kundër nëndeklarimit të pagave. Pavarësisht rritjes së regjistruar në të gjithë sektorët, bujqësia e peshkimi vijojnë me rrogat më të ulëta.

| PAGAT SIPAS SEKTORËVE | |
|---|---|
| **Bujqësia dhe peshkimi** | 61.224 |
| **Industria gjithsej** | 77.716 |
| **Ndërtimi** | 83.605 |
| **Tregtia;** | 74.715 |
| **Informacioni** | 143.528 |
| **Aktivitetet financiare** | 187.267 |
| **Pasuri të paluajtshme** | 96.894 |
| **Administrata publike** | 106.606 |
| **Arte, argëtim çlodhje;** | 86.209 |

Por përpos rritjes së pagave, e cila po nxitet edhe nga mungesat për punonjës, të dhënat më të fundit tregojnë se afro 25.8% e shqiptarëve paguhen deri në nivelin e pagës minimale.



LEXO EDHE:
**Të huajt mbushën hotelet në korrik, INSTAT: mbi 816 mijë turistë u akomoduan në Shqipëri**

Më pas janë 25.9% që paguhen mesatarisht nga mbi 50 mijë lekë deri në 75 mijë lekë në muaj, më tej janë 16.2% që marrin nga mbi 75 mijë deri në 95 mijë lekë. Rroga mbi 120 mijë lekë rezulton se marrin 17.1% e të punësuarve në vend.

| SA PAGUHEN SHQIPTARËT? | |
|---|---|
| **Deri në pagë minimale** | 25,8% |
| **50.001- 60.000 lekë** | 13,1% |
| **60.001-75.000 lekë** | 12,8% |
| **75.001-95.000 lekë** | 16,2% |
| **95.001-120.000 lekë** | 15% |
| **Mbi 120.000 lekë** | 17,1% |

Bazuar në të dhënat e INSTAT rezulton se minimalisht 52% e të punësuarve nuk e arrijnë pagën

mesatare të vendit. Sa i takon hendekut privat-shtet, ai vijon të jetë i lartë afro 21 mijë lekë. Paga mesatare për një të punësuar në privat është 86.094 lekë, nga 77.137 lekë që ishte në tremujorin e dytë vjet.

| **PAGA MESATARE NË PRIVAT** | |
|---|---|
| **Prill-Qershor 2025** | 77.137 lekë |
| **Prill-Qershor 2026** | 86.094 lekë |
| **Diferenca** | + 8,957 lekë |

Rritja në privat për këtë periudhë duket se ka qenë më e shpejtë se në shtet, pasi paga në sektorin privat është rritur me vetëm 7,565 lekë, krahasuar me vjet.

| **PAGA MESATARE NË SHTET** | |
|---|---|
| **Prill-Qershor 2025** | 99.525 lekë |
| **Prill-Qershor 2026** | 107.090 lekë |
| **Diferenca** | +7,565 lekë |
| | |

G.M./E.H/Shqiptarja.com

TAG: punesimi sektori privat sektori publik pagat Instat

Sa e vlerësoni këtë artikull? 4.3 / 5 (7 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

## Komente

Komento

Shabani: 14/09/2026 18:36

E di si asht kjo puna e mesatares. Ti ha dy puna e une asnje. Mesatarisht te dy kemi ngrene nga nje pule.

Përgjigju

Jari N: 14/09/2026 17:23

Ja keni futur pordhës, 50 % e Shqiptarëve marrin rrogë neto në muaj 40 000 mijë e ju na thoni 92 000 mijë, turp që na gënjeni.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Hapet thirrja për studentët ekselentë, 210 vende pune në 91 institucione publike! Aplikimet deri më 1 tetor (VIDEO)**

16 Shtator, 21:36



**Shtyhet përsëri CENSI i bujqësisë, do realizohet në 2027-ën! Kostoja 11.7 mln euro**



Eliza Gjediku

15 Shtator, 12:27



**PD: 1.1 mln shqiptarë u larguan drejt BE-së në 18 vite! 30 mijë nxënës më pak në 3 vite, shkollat po mbyllen (VIDEO)**

15 Shtator, 12:07



**Eduard Zaloshnja: Ku banojnë 4.28 milionë shtetasit shqiptarë që kanë lindur në Shqipëri?**



**Papunësia zbret në 8.3% në 3-mujorin e dytë 2026, por rritet te të rinjtë! INSTAT: Mbi 104 mijë**



**INSTAT: Paga mesatare në Shqipëri arrin në 92.150 lekë! Ndërtimi kryeson për rritjen në**

Eduard Zaloshnja

14 Shtator, 20:01

persona janë pa punë

10 Shtator, 12:58

tremujorin e dytë, ndërsa sektori financiar mbeten më i paguari

10 Shtator, 12:48



43 mijë vende pune bosh në 6 muaj, eksperti në Report TV: Politikat në arsim duhen ndryshuar, të rinjtë të orientohen drejt zanatit (VIDEO)

9 Shtator, 19:15



Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?

Eduard Zaloshnja

9 Shtator, 17:38



Inflacioni shqetëson qeverinë, do të ndërhyjë në treg me 'Pasqyrën e çmimeve", zv.ministri për Report TV: Platforma gati këtë muaj, qytetarët mundësi të zgjedhin marketet më ekonomike!

Eliza Gjediku

4 Shtator, 19:40



Filipinas, indian apo egjiptian: gati 30% e vendeve të lira të punës në vend tani u mbushën nga të huajt, 12 mijë morën leje në 6 muaj!

Eliza Gjediku

1 Shtator, 16:12



Aksidentet përgjakën rrugët në korrik, rritje me 26% krahasuar me 2025-ën! INSTAT: 235 të vdekur ose të plagosur vetëm në një muaj

Sokol Dema

27 Gusht, 13:00



Në Shqipëri vijnë aziatikët për të punuar, kurse Italia po merr punonjësit shqiptarë të tekstileve

27 Gusht, 12:47

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.